

LIGJ
Nr.9386, datë 4.5.2005

PËR MUZETË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat bazë për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe klasifikimit të muzeve në Republikën e Shqipërisë, si dhe organet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarive të tyre në shërbim të shoqërisë, me qëllim ekspozimin, ruajtjen dhe administrimin e objekteve muzeore, pjesë të pasurisë së trashëgimisë kulturore kombëtare.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore muzeore kombëtare.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Muze” është institucioni i ruajtjes së kujtesës, i ngjarjeve dhe dëshmime të shkruara e materiale të njeriut dhe të zhvillimit të shoqërisë, që ndërmerr kërkime, administron, ruan dhe ekspozon pasuritë muzeore, për qëllime studimore, edukuese dhe argëtuese, në shërbim dhe i hapur ndaj publikut.

Me termin “muze” kuptohen edhe:

a) qendrat arkeologjike dhe monumentet natyrore, arkeologjike e etnografike, si dhe qendrat dhe monumentet historike, që kanë natyrën e një muzeu për nga veprimtaria e tyre e ekspozimit, e ruajtjes dhe e komunikimit të dëshmime materiale e të shkruara të popujve dhe të mjedisit ku ata kanë jetuar;

b) institucionet, qendrat shkencore ose subjektet private, që ruajnë koleksione dhe paraqesin lloje (mostra) të ndryshme, të gjalla, bimore a shtazore, siç janë kopshtet botanike dhe zoologjike, akuariumet etj.;

c) subjektet, që ruajnë koleksione filatelike ose koleksione të tjera;

ç) galeritë e ekspozimit të veprave të artit;

d) arkivat audio, fotografikë, filmikë;

dh) parqet natyrore.

2. “Objekte muzeore” janë objektet ose materialet, të cilave studimet shkencore dhe dokumentare u kanë njohur vlera kulturore e historike, që ruhen, administrohen dhe ekspozohen në muze.

3. “Ndërtesë muze” është ndërtesa, pronë e paluajtshme, publike ose private, në të cilën janë ekspozuar objekte muzeore apo është shpallur e tillë për shkak të karakteristikave të saj.

4. “Objekt me rëndësi muzeore” është objekti, i cili për nga vlerat historike e kulturore plotëson kushtet për të qenë objekt muzeor, por nuk ndodhet i ekspozuar në ndonjë muze.

5. “Koleksion muzeor” është një bashkësi objektësh muzeore me karakteristika të përbashkëta në vlera historike dhe kulturore.

6. “Fond muzeor kombëtar” është e gjithë pasuria publike dhe private, me vlera muzeore, në administrim të muzeve publike ose private, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

7. “Muze tipologjik” është muzeu, që krijohet nga institucione publike, të profilizuara në një fushë të caktuar, por veprimtaria e tyre muzeore rregullohet sipas këtij ligji.

8. “Njohja zyrtare” është procesi i njohjes si të tillë të muzeve, që janë krijuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji apo që do të krijohen pas plotësimit të kriterëve specifike, që kërkohen në dispozitat e këtij ligji.

KREU II LLOJET E MUZEVE

Neni 4 Llojet e muzeve

1. Muzetë në Republikën e Shqipërisë janë publike ose private.
2. Muzetë publike janë kombëtarë, vendorë, tipologjikë apo në varësi të Akademisë së Shkencave.

Neni 5 Muzetë kombëtarë

1. Muzetë kombëtarë janë persona juridikë publike, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ata shpallen ose krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Komisionit Shtetëror të Muzeve.

2. Shpallja dhe krijimi i një muzeu kombëtar bëhet pasi të jenë plotësuar kriteret e mëposhtme:
a) fondet e objekteve muzeore që disponon muzeu duhet të jenë të tilla që të përmbledhin një numër të madh koleksionesh me vlera, shtrirje dhe rëndësi kombëtare;

b) të jetë në gjendje t’i sigurojë publikut profesionalizëm të lartë dhe të besueshëm në të gjithë fushën e koleksioneve që mbulon;

c) t’i sigurojë publikut të gjerë dhe studiuesve lehtësi hulumtimi dhe kërkimesh shkencore;

ç) t’u ofrojë vizitorëve shërbim cilësor.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miraton statutin e funksionimit të muzeve kombëtarë. Kalimi i një muzeu vendor në kombëtar, si dhe ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të muzeut bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, si dhe me këtë ligj.

4. Drejtuesit e muzeve kombëtarë emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 6 Muzetë në varësi të Akademisë së Shkencave

1. Muzetë në varësi të Akademisë së Shkencave janë persona juridikë publike, të cilët për shkak të specifikës së fondit muzeor që administrojnë, krijohen, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Komisionit Shtetëror të Muzeve, nga Akademia e Shkencave dhe janë në varësi të saj.

2. Statuti i funksionimit të muzeve në varësi të Akademisë së Shkencave miratohet nga Kryetari i Akademisë së Shkencave.

3. Drejtuesit e muzeve në varësi të Akademisë së Shkencave emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Kryetari i Akademisë së Shkencave.

Neni 7
Muzetë tipologjike

1. Muzetë tipologjike janë persona juridikë publikë, të cilët për shkak të profilizimit të tyre në një fushë të caktuar, si dhe të fondit muzeor që administrojnë, krijohen, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Komisionit Shtetëror të Muzeve, nga institucione të profilizuara dhe janë në varësi të tyre.
2. Statuti i funksionimit të muzeve tipologjike miratohet nga drejtuesit e këyre institucioneve.
3. Drejtuesit e muzeve tipologjike emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga drejtuesi i institucionit, nga i cili varen.

Neni 8
Muzetë vendorë

1. Muzetë vendorë janë institucione publike, që krijohen, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Komisionit Shtetëror të Muzeve, me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore dhe janë në varësi të tij. Statuti i funksionimit të muzeut vendor miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet muzeu.
2. Drejtuesit e muzeve vendorë emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 9
Muzetë privatë

Muzetë privatë krijohen nga persona fizikë apo juridikë privatë, organizata jofitimprurëse ose fondacione, të regjistruara në gjykatë dhe të licencuara nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas propozimeve dhe kriterëve të miratuara nga Komisioni Shtetëror i Muzeve.

KREU III
FUNKSIONIMI I MUZEVE

Neni 10
Drejtimi metodik dhe administrativ i muzeve publikë

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, përcakton normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sigurinë fizike të muzeve dhe të fondit muzeor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregullat në fuqi për fondin arkivor. Këto norma miratohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e të Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë muzetë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga lloji.
2. Nga pikëpamja e kompetencës administrative, muzetë drejtohen nga organi nga i cili varen apo nga institucioni në juridiksionin e të cilit ndodhet muzeu.

Neni 11
Mënyra e funksionimit të muzeut

1. Muzetë publikë dhe privatë funksionojnë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, të ligjeve nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", të legjislacionit fiskal në fuqi dhe në bazë të statutit të tyre.
2. Rregullat bazë të funksionimit të muzeut përcaktohen në statutin e tij, i cili përmban dispozita për:
 - a) misionin dhe qëllimin e muzeut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

- b) format e menaxhimit dhe të administrimit;
- c) burimet e financimit dhe mënyrën e krijimit të të ardhurave dhe menaxhimit të tyre;
- ç) fondin e objekteve të regjistruara dhe të dokumentuara në inventarin e Fondit Kombëtar Muzeor;
- d) të dhënat e strukturës, të organikës dhe të stafit drejtues të muzeut;
- dh) parimet kryesore për administrimin dhe kujdesin për koleksionet;
- e) parimet kryesore për mbështetjen e shërbimeve ndaj publikut, si dhe për marrëdhëniet me institucionet shtetërore, private dhe të tretët;
- ë) mënyrën e bashkëpunimit me institucionet e huaja simotra.

Neni 12

Struktura dhe organika e muzeut

1. Struktura dhe organika e muzeut duhet të jenë të përshtatura me funksionin dhe qëllimin për të cilin janë krijuar, në përputhje me politikën dhe misionin, në shërbim të shoqërisë dhe të edukimit të saj.
2. Çdo muze, për të përmbushur qëllimin dhe funksionet e veta, duhet të ketë një personel të kualifikuar, në përputhje dhe sipas llojit të fondit muzeor që administron.
3. Struktura dhe organika e muzeve kombëtarë propozohen nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe miratohen me urdhër të Kryeministrit.
4. Struktura dhe organika e muzeve, në varësi të Akademisë së Shkencave, miratohen nga Këshilli Ekzekutiv i Akademisë së Shkencave.
5. Struktura dhe organika e muzeve tipologjikë miratohen nga drejtuesit e institucionit, në varësi të të cilit është muzeu.
6. Struktura dhe organika e muzeve vendorë miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, në juridiksionin e së cilës është muzeu.
7. Për muzetë privatë kjo e drejtë i takon personit fizik a juridik, që ka krijuar muzeun.

Neni 13

Detyrimi për sigurimin e muzeut

Drejtuesit e muzeve, publikë dhe privatë, detyrohen të garantojnë sigurinë e mjediseve dhe të fondit muzeor, që kanë në administrim, ndaj të gjitha rreziqeve të mundshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 14

Ofrimi i shërbimit ndaj publikut

1. Muzetë i ofrojnë mundësinë publikut për ta vizituar, kundrejt një çmimi, i cili përcaktohet në biletën e muzeut. Formatit dhe çmimi i biletës së muzeve kombëtarë miratohen me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa për muzetë vendorë, miratohet nga drejtuesi i njësisë së qeverisjes vendore, nga e cila varet muzeu.
2. Formatit dhe çmimi i biletës së muzeve në varësi të Akademisë së Shkencave përcaktohen nga Kryetari i Akademisë së Shkencave.
3. Formatit dhe çmimi i biletës së muzeve tipologjikë përcaktohen nga drejtuesi i institucionit, në varësi të të cilit është muzeu.
4. Të gjitha të ardhurat, që vijnë nga shitja e biletave të muzeve publikë përdoren sipas përcaktimit të nenit 20 të këtij ligji.
5. Çmimi dhe formati i biletës për muzetë privatë përcaktohen nga drejtuesi i muzeut privat.
6. Për kategori të caktuara shoqërore, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, vendosen çmime të reduktuara të biletave të muzeve publikë.

KREU IV

FONDI MUZEOR KOMBËTAR

Neni 15
Fondi Muzeor Kombëtar

1. Objektet muzeore regjistrohen në inventarin e Fondit Muzeor Kombëtar, i cili hartohet dhe administrohet nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, më tej QKIPK, institucion shkencor, i specializuar, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Kalimi i një ose disa objekteve nga një muze në një muze tjetër publik, për shkak të rëndësisë së tij/tyre, në rastet e keqadministrit, të pamundësisë për miradministrim të një fondi muzeor, bëhet me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Dhënia për shfrytëzim të përkohshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, pjesë të Fondit Muzeor Kombëtar nga një muze te një muze tjetër publik, ose pjesëmarrja në ekspozita brenda vendit bëhet me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4. Muzetë publikë shkëmbejnë ndërmjet tyre objekte muzeore, pas miratimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, si dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet tyre.

5. Në çdo rast, lëvizja e objekteve muzeore nga një muze në një muze tjetër, pasqyrohet në inventarin e Fondit Muzeor Kombëtar, që administrohet nga QKIPK-ja.

6. Fondi Muzeor Kombëtar mbrohet dhe administrohet sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

KREU V
KOMISIONI SHETETËROR I MUZEVE

Neni 16
Komisioni Shtetëror i Muzeve

1. Komisioni Shtetëror i Muzeve, më tej KSHM, është organ vendimmarrës, i specializuar në fushën e muzeve, kryetar i të cilit është Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Kompetencat, përbërja, funksionimi, mënyra e mbledhjes dhe e shpërblimit të anëtarëve të KSHM-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në përbërje të KSHM-së zgjidhen përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara dhe personalitete të shquara në fushën e muzeologjisë.

KREU VI
RIORGANIZIMI, MBYLLJA DHE NJOHJA ZYRTARE E MUZEVE PUBLIKË

Neni 17
Riorganizimi dhe mbyllja e muzeve

1. Riorganizimi dhe mbyllja e muzeve publikë bëhen nga organi që i ka krijuar, duke marrë më parë mendimin e KSHM-së.

2. Në rast mbylljeje të një muzeu publik, KSHM-ja vendos për zhvendosjen e fondit muzeor të muzeut që mbyllet në një muze tjetër publik.

Neni 18
Njohja zyrtare dhe regjistrimi i muzeve publikë

1. Çdo muze publik duhet të jetë i njohur zyrtarisht.
2. Njohja zyrtare e një muzeu bëhet me vendim të KSHM-së, pasi të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme, sipas specifikimeve të bëra nga ky organ:
 - a) të ketë një statut të miratuar, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - b) të ketë përmbushur detyrimin për sistemin e sigurimit, i cili garanton zhvillimin e veprimtarisë;
 - c) fondet muzeore dhe ndërtesa e tij të dëshmojnë vlera të rëndësishme muzeore, në shërbim të publikut.
3. Formulari përkatës me specifikimet e kriterëve të mësipërme jepet nga Komisioni Shtetëror i Muzeve.
4. Muzetë e njohur zyrtarisht regjistrohen në regjistrin e muzeve, i cili mbahet nga KSHM-ja.
5. Kur një muze publik nuk plotëson kushtet për t'u njohur zyrtarisht, kërkesa për njohjen e tij ribëhet brenda një periudhe dyvjeçare. Kur muzeu nuk njihet zyrtarisht as për të dytën herë, KSHM-ja i propozon institucionit apo organit nga i cili muzeu varet administrativisht mosfinancimin e mëtejshëm të tij.

KREU VII FINANCIMI I MUZEVE

Neni 19

Financimi i muzeve publikë

1. Muzetë publikë financohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për organet përkatëse, që i kanë në varësi këto muze, duke i dhënë fonde për:
 - a) mbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave muzeore;
 - b) pagesat e shërbimeve të nevojshme, taksat dhe qiranë e tokës;
 - c) zgjerimin e ndërtesave muzeore, ruajtjen e tyre (sistemi i sigurisë, mbrojtja nga zjarri);
 - ç) pajisjet për kontrollin e temperaturave të mjedisit të muzeut, për ruajtjen dhe restaurimin e objekteve muzeore;
 - d) pagesat e stafit;
 - dh) bashkëpunim ndërkombëtar.
2. Muzetë publikë mund të financohen dhe nga burime të tjera, në formën e donacioneve ose të dhuratave, si dhe nga të ardhurat e shërbimeve që kryejnë.

Të ardhurat e krijuara nga shitja e biletave, dhënia me qira e mjediseve dhe nga shërbime të tjera të ofruara nga muzeu, përdoren në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.
3. Muzetë publikë kur marrin një donacion ose dhuratë, për një qëllim të përcaktuar qartë ose të papërcaktuar, të ardhurat i kalojnë muzeut dhe përdoren vetëm për realizimin e këtij qëllimi ose për shërbime a investime të tjera në muze.

Neni 20

Të ardhurat nga shitja e biletave, nga veprimtaritë dhe shërbimet e tjera

1. Ndarja e të ardhurave, që vijnë nga shitja e biletave, nga shërbime e veprimtari të tjera në muzetë publikë, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Mënyra e përdorimit të të ardhurave, që u kalojnë muzeve, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë të Financave.

Neni 21

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Muzetë publikë brenda fushës së veprimtarisë së tyre bashkëpunojnë me muzetë e vendeve të tjera, aderojnë në organizata muzeore ndërkombëtare dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, që burojnë nga ato. Për çdo bashkëpunim ndërkombëtar, muzetë duhet të marrin më parë mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të organeve përgjegjëse, nga të cilat varen.
2. Efektet financiare për pjesëmarrjen e muzeut publik në organizmat ndërkombëtarë përballohen nga buxheti i institucionit apo nga organi që e ka muzeun në varësi administrative.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22
Dispozita kalimtare

Njohja zyrtare e muzeve publikë në Regjistrin Kombëtar të Muzeve bëhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të kërkesave të tij.

Neni 23
Aktet ligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14 pika 6, 16 pika 2 dhe 20 pika 1 të këtij ligji.

2. Ngarkohen këshillat e njësive të qeverisjes vendore, Akademia e Shkencave dhe institucionet, që kanë muze në varësi të tyre, të cilat, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të bëjnë riorganizimin dhe miratimin e statuteve të muzeve në varësi të tyre, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4592, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**